



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2843/12 prot.

Datë 08.01.2024

V E N D I M
Nr. 19/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1316/2023, datë 15.12.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe ëeb serviseve për pagesa” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Qarku Shkodër.

Ankimues: BOE “Primus Albania” SHPK me NUIS L42202028V, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1 Tiranë & “Nexia AI Consulting” SHPK, me NUIS L82210031Q, me adresë: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tiranë

Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me NUIS L12121023B, me adresë: Njësia Bashkiake nr. 5, Rruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra nr.2 ,Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqeria Rajonale Ujesjetles Kanalzime Qarku Shkoder me adresë: Lagjia 3 Heronjte, Rruga Marin Biçikemi, Shkoder

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021
“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe
Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 15.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1316/2023, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe ëeb serviseve për pagesa” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 23.10.2023, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër.
2. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK dhe operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, duke i kualifikuar ata.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Primus Albania” SHPK & “Nexia Al Consulting” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kreatx” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.2439/1 prot., datë 28.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2843/9 prot., datë 03.01.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1316/2023, datë 15.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe ëeb serviseve për pagesa” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.2439/1 prot., datë 28.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2843/9 prot., datë 03.01.2024, autoriteti kontraktor njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1316/2023, datë 15.12.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “*Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe ëeb serviseve për pagesa*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi veprimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, nga ana e autoritetit kontraktor. Nga ky verifikim rezultoi se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.1316/2023, datë 15.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr.REF-83007-10-10-2023, me objekt: “*Upgrade i programit të faturimit, migrim i të dhënave, audit dhe ëeb serviseve për pagesa*” me fond limit 1.500.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 23.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

